

Samiti i diasporës

Paneli: Inovacioni dhe Ekselenca

Datë 23.11.2023 ora 16.30-18.30

Vendi: Pallati i Kongreseve, holli kryesor

Moderator: Prof. As. Linda Pustina, Kryetare e Ekipit Kombëtar për Strategjinë e Specializimit Inteligjent (S3), Këshilltare e Zëvendëskryeministres

Panelistë:

Znj. Belinda Balluku, Zëvendëskryeministre dhe Ministre e Infrastrukturës dhe Energjisë

Z. Alfred Peza, Drejtor i Pergjithshëm i Radio Televizionit Shqiptar

Znj. Elizabeta Katiaj, zv/Kryetare e Dhomës së Biznesit të Diasporës

Znj. Enkelejda Imeraj, eksperte në Tech Innovation, USA

Dr. Altin Palloshi, Mjek Kardiolog Interventist, Zv. Shef i ICCS/Heart Valve Center - San Raffaele, Milano, Itali

Prof. Arben Merkoci, drejtues i ICN2 Nanobioelectronics and Biosensors Group, Spanjë

Z. Aris Golemi, CEO Exel Talents Agency, USA

Z. Rio Sheri, ekspert për Simulimin e Sulmeve Kibernetike, IBM, Mbretëri e Bashkuar

Temat e Panelit: Inovacioni dhe Ekselenca

Ndikimi i politikave qeveritare për angazhimin e diasporës dhe përthithjen e trurit dhe ekselencës.

Rëndësia e medias për të krijuar ura lidhëse me Diasporën dhe iniciativat më të fundit që po ndërmerren nga Radio Televizioni Shqiptar: hapja e kanalit të ri TV "RTSH Diaspora" dhe programi që fillon së shpejti në RTSH1 "Shqipëria Inteligjente" i ideuar dhe realizuar nga RTSH dhe Ekipi Kombëtar i S3.

Risitë dhe zhvillimet e fundit për mbështetjen e diasporës dhe thithjen e trurit dhe ekselencës. Masat që parashikohet të ndërmerren në kuadër të Strategjisë për Specializimin Inteligjent-S3.

Mbështetja që profesionistët ekselentë në diasporë japin në mbështetjen e reformave qeveritare dhe në transferimin e njohurive, duke përcjellë praktikat më të mira nga jashtë, duke vendosur në dispozicion njohuritë dhe eksperiencën e tyre të akumuluar ndër vite, si dhe duke lobuar për Shqipërinë. Impakti social, si dhe ai në zhvillimin ekonomik inovativ dhe smart të Shqipërisë.

Roli i organizatave dhe dhomave të biznesit në mbështetje të përfshirjes së diasporës në zhvillimin ekonomik të vendit. Incentivat dhe mbështetja që duhet të parashikohen për të tërhequr ekselencën nga diaspora.

Promovimi i Shqipërisë dhe shqiptarëve: roli i ekselentëve në diasporë si modele të inovacionit dhe ekselencës në botë.

Brain circulation si një koncept për angazhimin e diasporës në zhvillimin ekonomik, social e kulturor të Shqipërisë, krijimin e ndërlidhjes me ekspertët që punojnë e jetojnë në Shqipëri, dhe si një hap i domosdoshëm për kthimin e diasporës në Shqipëri.

Krijimi i platformave virtuale gjithëpërfshirëse të komunikimit si një mjet inovativ për të krijuar ura lidhëse mes profesionistëve në diasporë dhe në Shqipëri, qeverisjes qendrore dhe vendore, biznesit, dhe shoqërisë civile.